



19 MARS 2020

Masat e marra në kuadër të Pandemisë COVID-19 nga Autoritetet Shqiptare

Për shkak të përhapjes së virusit COVID-19 Autoritetet Shqiptare kanë marrë një sërë masash për të parandaluar përhapjen e tij. Më poshtë janë të listuar të gjitha masat e ndërmarra deri më datë 19 Mars 2020.

Permbajtja

KUFIZIMI I LËVIZJES	1
VETËKARANTINIMI	2
MBYLLJA E AKTIVITETEVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE	2
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE	4
KËSTET E KREDIVE.....	4

KUFIZIMI I LËVIZJES

Do të lejohet lëvizja e këmbësorëve në këto orare:

- 06:00 – 10:00
- 16:00 – 18:00

Për të gjithë ata individë që nuk do të respektojnë këtë orar do të aplikohet gjobë në vlerën 10'000 lekë dhe do të procedohet me bllokimin e automjetit për një periudhë 3-mujore nëse individi disponon një të tillë.

Do të lejohet lëvizja e mjeteve (autobusë, furgona, etj.) për transportin e personelit të bizneseve me aktivitet të lejuar në këto orare:

- 06:00 – 08:00
- 16:00 – 17:00

Këto biznese duhet të pajisen me autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Për aplikimin për autorizim duhet të përgatiten dhe dorëzohen dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë nga subjekti



- Të dhënat e mjeteve të transportit që do të përdoren
- Të dhënat e personelit

Nëse subjekti nuk garanton transportin e personelit, individët mund të përdorin automjetin privat pasi të dorëzojnë formularin e vetë deklarimit, i cili mund të gjendet në link-un e mëposhtëm:

["Covid-19" - Lëvizja e kontrolluar me mjet!](#)

Deklarimet e pasakta e ngarkojnë individin me përgjegjësi penale dhe administrative.

Autoritetet Shqiptare kanë njoftuar mbylljen e Pikave Kufitare me shtetet fqinje (Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni, Greqi). Janë ndaluar të gjitha fluturimet drejt dhe nga Italia & Britania e Madhe. Këto kufizime do të qëndrojnë në fuqi deri në nxjerrjen e një njoftimi të dytë nga Institucionet përkatëse.

VETËKARANTINIMI

Të gjithë shtetasit që hyjnë në Republikën e Shqipërisë duhet të deklarojnë ardhjen e tyre nga një shtet i prekur nga COVID-19. Pas deklarimit shtetasi duhet të vetëkarantinohet për një periudhë 14-ditore. Do të vetëkarantinohen të gjithë shtetasit që kanë rezultuar pozitiv me COVID-19 sipas urdhrimit të organeve kompetente. Nëse do të konstatohen shkelje për udhëzimet e mësipërme individit do të dënohet me gjobë në vlerë 700'000 lekë.

MBYLLJA E AKTIVITETEVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka urdhëruar mbylljen e institucioneve publike dhe jo publike deri më datë 23 mars 2020. Institucionet arsimore, çerdhet dhe kopshtet, publike e jopublike të cilat nuk e mbyllin aktivitetin e tyre për periudhën e përcaktuar dënohen me gjobë në vlerën 5'000'000 lekë për institucionet arsimore dhe në masën 1'000'000 lekë për çerdhet dhe kopshtet, publike/jopublike. Në rast përsëritje do të aplikohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka urdhëruar mbylljen në të gjithë vendin të bareve, restoranteve, fast food, lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët deri në datë 3 prill



2020. Përfundimi nga ky urdhër bëhet vetëm për shërbimin në banesë (delivery) i cili duhet të kryhet duke pasiguar janë përmbushur rregullat higjienike të miratuara. Subjektet apo individët që nuk e zbatojnë këtë urdhër dënohen me gjobë në vlerën 1'000'000 lekë. Në rast përsëritje, do të mbyllet veprimtaria për një periudhë 6-mujore.

Prej datës 17 Mars 2020 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka pezulluar shërbimet në sportelet dhe zyrat e Shërbimit për Tatimpaguesit.

Gjatë kësaj periudhe, për çdo shërbim apo kërkesë, tatimpaguesit mund të drejtohen në platformat elektronike të mëposhtme:

- Portali e-Albania
- Portali e-filing
- Numrave të telefonit dhe e-maileve zyrtare të drejtorive rajonale
- Qendrës së thirrjeve në numrin 0800 000
- Komunikimit duke ju drejtuar faqes zyrtare të internetit tatime.gov.al

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) ka pezulluar shërbimet pranë sporteleve fizike. Shërbimet e QKB-së, për regjistrimin dhe liçensimin e biznesit do të ofrohen vetëm nëpërmjet e-Albania.

Për çdo problematikë subjektet mund të kontaktojnë në:

- Numrin e telefonit +355 (0)4 225 0066
- Adresën e e-mailit info.qkb@qkb.gov.al

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV) ka pezulluar shërbimet pranë sporteleve fizike. Për të marrë asistencë subjektet mund të kontaktojnë nëpërmjet:

- Shërbimin Postar
- Adresën elektronike zyrtare të DPTTV (taksat@tirana.al)
- Numrat e kontaktit të vendosur në dispozicion 0800 8080/ 00355 (0)4 241 9705

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pezulluar veprimtarinë dhe shërbimet gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, me juridiksion të përgjithshëm dhe të posaçëm deri më 24 Mars 2020.

Përfundohen nga efektet e këtij pezullimi veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore, që lidhen me çështje me natyrë të ngutshme, të vlerësuara si të tilla rast pas rasti nga gjyqtari si dhe seancat e vlerësimit të masave të sigurisë, kur të arrestuarit, të pandehurit, ose mbrojtësit e tyre e kërkojnë shprehimisht që të vijohet me shqyrtimin e tyre.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton se tërheqja e dokumentacionit tatimor (bllloqe faturash TVSH, Model 4, dëftesa tatimore, etj.) do të vijojë të kryhet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku tatimpaguesit janë të regjistruar, gjatë orarit zyrtar të punës, e Hënë – e Enjte ora 08:00 – 16:00 dhe e Premte 08:00 – 14:00. Për informacione të mëtejshme mund t’i referoheni link-ut të mëposhtëm:

[*Njoftim i përditësuar mbi mënyrën e shpërndarjes së dokumentacionit tatimor*](#)

Tatimpaguesit mund ti paguajnë detyrimet tatimore elektronikisht nëpërmjet bankave të nivelit të dytë si dhe nëpërmjet Platformës Qeveritare të Pagesave në e-Albania. Për informacione të mëtejshme mund t’i referoheni link-ut të mëposhtëm:

[*Pagesat Elektronike*](#)

KËSTET E KREDIVE

Banka e Shqipërisë ka njoftuar se afati i pagimit të kësteve të kredive për biznese dhe individë shtyhet deri më datë 31 maj 2020.

Ky rregull vlen për të gjithë kredi marrësit, të cilët janë përballur me vështirësi në këtë periudhë si pasojë e COVID-19. Institucionet e kreditimit kanë detyrimin të shprehen mbi kërkesën brenda një periudhe 3-ditore nga marrja e saj.